



*Republika e Kosovës*  
*Republic of Kosova*



*Komuna Hani i Elezit*  
*Municipality of Hani Elezit*

## **DREJTORIA PËR EKONOMI, FINANCA DHE BUJQËSI**

Menaxhmenti i drejtorisë së Ekonomisë , Financave dhe Bujqësisë ( DEFB),duke u bazuar në rolin dhe rëndësinë që ka plani – Programi operativ i punës, në funksionimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të saja të punës për vitin 2011, hartimit të këtij draft-dokumenti iu ka qasur me një përkushtim të caktuar.

Gjatë përgatitjes dhe përpilimit të këtij drafti të punës kemi konceptuar,

- vizionin,misionin e drejtorisë dhe një gjithë përfshirje të të gjitha objektivave të punës ;
- përshkrimin dhe konkretizimin e të gjitha detyrave dhe përgjegjësive sipas sektorëve funksional, duke u mbështetur në objektivat e përgjithshme të drejtorisë, dhe
- përcaktimin e bartësve të aktiviteteve me afatizime kohore për realizimin e tyre.

### ***VIZIONI***

#### **Vizioni i përgjithshëm i DEFB- do të jetë:**

- planifikimi, menaxhimi, mbykqyrja ,dhe operimi sa më i arsyeshëm e efikas dhe transparent i mjeteve buxhetore të komunës;
- mbështetja permanente e biznesit përmes krijimit të një ambienti më të favorshëm të zhvillimit;
- bashkëpunimin me MEF me qëllim të perligjesimit të të gjitha aktiviteteve në sektorin e buxhetit dhe financave;
- si dhe një zhvillim të gjithmbarshëm socio-ekonomik të komunës.

### ***MISIONI I DREJTORISË***

Në bashkëpunim dhe koordinim me drejtoritë-programet tjera buxhetore të komunës, DEFB siguron një planifikim më të mirëfilltë, një menaxhim më të drejtë dhe më transparent të shpenzimit të parasë publike, pastaj evidentimin dhe regjistrimin e të gjitha transaksioneve financiare si të shpenzimeve, ashtu edhe të hyrave buxhetore nga të gjitha burimet, mirëmban të gjitha llogaritë e komunës në bashkëpunim me thesarin, menaxhon me pagesat, mbykqyrë dhe bën monitorimin e sistemeve dhe procedurave për ekzekutimin e buxhetit.

Harton, udhëheq dhe është përgjegjëse kryesore e buxhetit të komunës, duke filluar nga fazat nismëtare të zhvillimit të procedurave të planifikimit, e deri në fazën e fundit të miratimit të draft-buxheteve në Kuvend, pastaj përgatit dhe harton raportet mbi realizimin e mjeteve buxhetore sipas standardeve të kërkuara nga MEF-i, në pajtueshmëri të plotë me Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me Ligjin nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal dhe dispozitave tjera ligjore .

Në sferën e ekonomisë, bën pajisjen e bizneseve me leje të punës, bën inspektimin e tyre dhe të tregut konform kompetencave të lejuara; zbaton rregulloren mbi tarifatat dhe ngarkesat vjetore, të cilat kanë të bëjnë me drejtorinë, duke bërë inkasimin e drejt për drejt të të hyrave komunale nga taksa obliguesit, me theks të veçantë , arkëtimin e të hyrave nga tatimi në pronë dhe taksat nga biznesi.

#### **OBJEKTIVAT:**

Për vitin 2011 në mesin e shumë objektivave të parashikuara si më prioritare do ti veçonim,

- Përbushja e të gjitha obligimeve legjislativë që rrjedhin nga dispozitat ligjore të nivelit qendror, atij komunal dhe nga statuti i miratuar i komunës në pregaditjen dhe hartimin e dispozitave ligjore , si dhe në zbatimin e tyre;
- Shtimi i mëtejshëm i bashkëpunimit reciprok me të gjitha drejtoritë-programet buxhetore, me ministritë përkatëse të pushtetit qendror si me MEF-in, MTI-në, MAPL-në dhe MSHP-në ,APK-në dhe gjithsesi edhe me biznesin lokal;
- Përforcimi i aktiviteteve ekonomike në rrafshin komunal duke i ushtruar kompetencat e lejuara nga lartë dhe hapësirës së mundshme të bashkëpunimit;
- Krijimi i një ambienti sa më të volitshëm për zhvillimin e NVM-ve dhe biznesit të pavarur me të gjitha format e mundshme - për një gjenerim dhe hapje të perspektivës zhvillimore të komunës.
- Përgatitja e akteve ligjore dhe parakushteve tjera për shtimin e efikasitetit në grumbullimin e të hyrave buxhetore duke u studiuar mundësia e instalimit të gjeneratorëve të rinj dhe hulumtimin e mekanizmave më adekuat për krijimin e një buxheti sa më të pasur - për të mundur në një periudhë të afërme, buxheti i komunës ti mbuloj shpenzimet publike në pajtim me vendimet e kuvendit të komunës dhe kërkesave të qytetareve.
- Zhvillimi i aktiviteteve dhe procedurave në ciklet e planifikimit buxhetor, menaxhimi, mbykqyrja dhe operimi sa më i arsyeshëm dhe transparent me mjetet buxhetore në pajtim me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë me nr. 03/L-048 , me Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal me nr. 03/ L-049, si dhe akteve tjera ligjore nga kjo lëmi.
- Krijimi i një bashkëpunimi me të gjitha institucionet komunale dhe ato në nivel të vendit, pra me donatorët, për të përfituar donacione për realizimin e projekteve, të cilat do të mundësonin zbatimin konsekuent të politikave zhvillimore dhe realizimin e kërkesave

dhe nevojave sipas listës së projekteve prioritare të investimeve kapitale për vitin 2011 dhe 2012-2013 duke mos zhvlerësuar partneritetin me komunitetin e biznesit dhe shoqërinë civile.

- Instalimin e një softveri të programit të kontabilitetit për të pasur një efikasitet në punë për ruajtjen e shënimeve dhe borgjeve ndaj taksapaguesëve.

## ***SEKTORI I BUXHETIT***

Përgatitja e propozim vendimit dhe hartimi i draftit të ri të buxhetit shtesë (suplementar), të dytin me radhë , për vitin 2011, nga se në fund vitin që e lamë pas, përsëri kemi tejkalim të hyrave buxhetore nga të hyrat vetanake komunale;

### **Janar - Mars**

- Përpilimi dhe përgatitja e planit të rrjedhjes së parasë së gatshme për të gjitha programet dhe nënprogramet buxhetore, me zotimin dhe shpenzimin e parashikuar të mjeteve buxhetore nga granti qeveritar dhe të hyrave vetanake komunale (HVK-të), sipas dinamikës së parashikuar mujore, për vitin 2011;
- Përgatitja e propozim vendimit dhe hartimi i draftit për bartjen e bilanceve të pashpenzuara – nga të hyrat vetanake komunale, nga viti 2010 në buxhetin e vitit vijues 2011.
- Përgatitja e draft raportit preliminar apo raporti i përkohshëm mbi realizimin e mjeteve buxhetore në nivel të komunës për vitin 2010 sipas pasqyrave tabelore dhe standardeve të rekomanduara;
- Përgatitja e raportit final, të konsoliduar dhe analitik të bilancit të gjendjes dhe pasqyrave financiare për vitin 2010 për organizatën buxhetore të komunës- sipas udhëzimit administrativ nr.2008/13 – mbi raportimin vjetor të organizatave buxhetore nga MEF-i me format standarde të thesarit sipas Standardeve Ndërkombëtare për Kontabilitet dhe Financa Publike (SNKFP), me shpalosjet e nevojshme dhe pas barazimit definitiv reciprok me MEF-in , përkatësisht me departamentin e thesarit.
- Përgatitja dhe evidentimi i të dhënave të miratuara buxhetore, përpunimi dhe futja e të dhënave në sistemin unik në nivel të vendit i ashtuquajturit Sistemi për përpilimin dhe menaxhimin e buxhetit (BDMS) të aprovuar për periudhën e viteve 2011-2013.
- Zhvillimi i procedurave dhe aktiviteteve për përgatitjen e draft buxhetit afat mesëm të komunës për periudhën e viteve 2011-2014, përkatësisht buxhetin për vitin 2012 dhe projeksionet për vitet 2013 dhe 2014, sipas qarkores buxhetore 2011/01- për komunat duke u bazuar në kufijtë buxhetor të komisionit të grandeve dhe kërkesave buxhetore nga programet dhe nënprogramet buxhetore të komunës, duke përfshirë edhe identifikimin e projekteve nga komuniteti përmes dëgjimeve obligative publike;
- Ndërmjetësimi dhe asistimi ynë në regjistrimin e përhershëm të bizneseve dhe emrave tregtarë të bizneseve që operojnë në Komunën tonë, d.m.th. për regjistrimet e reja të bizneseve, modifikimet dhe ndërprerjet e tyre sipas aplikacioneve të parashtruara;

- Lëshuarja e proceseve për lokalet afariste të cilat i plotësojnë kushtet higjienike-teknike dhe të punës – harmonizimi i kësaj çështje brenda drejtorive për tre inspeksionet apo të veçanta nga secili inspektor, për bizneset e reja sipas kërkesave të parashtruara ;

#### **Mars**

- Shqyrtimi i rregullores për taksa , tarifa dhe ngarkesa komunale.

#### **Prill**

- Përgatitja dhe hartimi i propozim – rregullores komunale mbi dhënien e lejeve të punës për subjektet afariste dhe funksionimi i tyre.
- Përgatitja-shtypja dhe shpërndarja e aktvendimeve mbi ngarkesën vjetore për të gjitha bizneset në territorin e komunës për vitin 2011, mbështetur në rregulloren komunale mbi tarifrat dhe ngarkesat administrative dhe shërbimeve tjera;

#### **Qershor**

- Rishikimi gjashtëmujor i buxhetit (RGJB) për vitin 2011 në nivel të organizatës buxhetore të komunës, me propozimet konkrete të ndryshimeve dhe korigjimeve brenda gjashtë (08) programeve buxhetore dhe sipas kategorive ekonomike(KE) të shpenzimeve.

#### **Qershor-Shtator**

- Hartimi i raporteve të konsoliduar të gjashtë (08) programeve buxhetore mbi realizimin e mjeteve buxhetore për vitin 2011, sipas tremujorëve dhe prerjeve të caktuara mujore;

#### **Korrik-Gusht**

- Azhuriteti në mbajtjen e librave dhe evidencave financiare për sigurimin e suksesshëm të auditimeve të pritura dhe vjetore që janë obligative, qoftë nga auditorët intern të MEF-it apo edhe nga Zyra e Revizorit Gjeneral(ZRGJ);

#### **Janar - Dhjetor**

- Mbajtja e evidencave me përpunim elektronik për të gjitha bizneset e regjistruara, krijimi i regjistrave të bizneseve aktive dhe të regjistrave të posaçme sipas veprimtarive sektoriale , lokacionit, numrit të të punësuarve dhe kategorizimeve tjera relevante;

**Shërbimi i Inspeksionit** – do të angazhohet në inspektimin permanent të subjekteve ekonomike, kontrollimin e tregut, kontrollimin e lejeve të punës për ushtrimin e bizneseve dhe lokaleve - hapësirës së punës, në pengimin e ushtrimit të veprimtarive nga tregtarët joformal dhe në largimin permanent të shitësve në rrugë dhe trotuare të cilët merren me veprimtari tregtare pa leje pune , pastaj me aktivitetet rreth bizneseve në përbushjen e obligimeve të vitit 2011 dhe ato të pa paguara nga vitet paraprake , në zbatimin me përpikëri të vendimit komunal mbi orarin e punës dhe aktivitetet tjera në pajtim me legjislacionin në fuqi nga kjo fushëveprimtari si: ligjit për zejtari nr. 2004/44, ligji mbi veprimtarinë hoteliere dhe turistike nr. 2004/16 dhe ligjit mbi tregtinë e brendshme nr. 2004/18.

#### **Janar - Dhjetor**

- Përkrahja e NVM-ve për një ambient sa më të favorshëm biznesor me mbështetjen e kërkesave të tyre që kanë të bëjnë me zhvillimin e biznesit në territorin e komunës pastaj në kontekst të ofrimit të këshillave dhe ndihmave për përmirësimin e mëtejme dhe avancimin e pozitës ekonomike të subjekteve biznese në zbatimin e një politike fiskale reale gjithmonë duke mos e rënduar afarizmin e bizneseve, përkrahja në ndërtimin e objekteve të infrastrukturës etj.
- Zhvillimi i aktiviteteve për joshjen e investimeve të reja dhe mbështetja e të gjitha iniciativave që vijnë nga sfera e konsumit investiv, si nga investitorët e brendshëm apo edhe nga ato të jashtëm, e që kanë të bëjnë me programet investive në infrastrukturë apo drejtpërdrejt në ngritjen e kapaciteteve prodhuese në territorin e komunës:
- Vendosja e kontakteve të bashkëpunimit me ministrinë e qeverisë qendrore e sidomos me ministrinë e transportit (MTPT) dhe të pushtetit lokal (MAPL) për sigurimin e mjeteve investive për bashkëfinancimin e projekteve kapitale sipas listës së projekteve prioritare për vitin fiskal 2011 i kemi parashikuar mjete investive në shume prej **396,836 €**
- Për këtë vit, nga niveli qendror përkatësisht nga fondet e MTPT, MAPL, Komisionit Evropian, Llogos-it presim mbështetje shumë më të madhe financiare për financimin e projekteve kapitale në vitin 2011, ndërsa nga komuniteti kërkojmë që krahas pregaditjes nga ana e tyre të projekteve të detajizuara të infrastrukturës ,të pagesës së obligimeve të komunës- sidomos të tatimit në pronë me mjete të bëjnë edhe participimin e nevojshëm .
- Mbajtja e kontakteve me Agjencionin për Promovimin e Investimeve në Kosovë (APIK) dhe vazhdimi me aktivitetet e mëtejme lidhur me realizimin e projekteve të propozuara nga konferenca me donatorët, e mbajtur në muajin 07/2008, të cilat projekte janë përpunuar dhe kanë hyrë në sistemin unik të vendit-sistemin e PIP- ave.

## ***SEKTORI I THESARIT-PAGESAVE***

### **Janar**

- Shfrytëzimi dhe përdorimi direkt i programit të instaluar të “ Sistemit të Informatave mbi Menagjimin Financiar të Kosovës” (SIMFK-ja) në nivel të komunal, me qasje të drejtpërdrejt në regjistrimet dhe evidentimet e të hyrave, të dalurave buxhetore dhe pasurisë së komunës, me lejimin e mundësive të ndërhyrjes , në zotimet e mbetura, korrigjimi i tyre në kontinuitet edhe procedimi i drejtpërdrejt i shpenzimeve tona në zyrën e thesarit komunal për të gjitha pagesat me përjashtim të transfereve ndërkombëtare që bëhen në thesarin qendror.

### **Janar -Dhjetor**

- Përpunimi, harmonizimi dhe barazimi i evidencave të detajizuara të të gjitha llojet e të hyrave dhe të dalurave buxhetore sipas programeve dhe nënprogrameve buxhetore, fondeve dhe kodeve ekonomike me “free-balance” , pastaj mbajtja e evidencave të veçanta të mjeteve të ndara në formë të zotimeve të mjeteve dhe ato të shpenzuara, regjistrimi i aseteve dhe pasurisë së komunës sipas gjendjes së fundvitit dhe ato të furnizuara gjatë vitit 2010;
- Mbajtja e evidencave të sakta dhe shtimi i efikasitetit në arkëtimin dhe bankimin e pagesave- inkasimet në arkë, depozitimet bankare, transferi i të hyrave komunale dhe alokimi i këtyre mjeteve nga fondi i BQK-së;

- Arkëtimi i të gjitha llojeve të pagesave në arkën e DEFB deri në limitin e përcaktuar prej **25,00 euro** duke i sistemuar të gjitha llojet e pagesave dhe depozitimit çdo ditë i këtyre arkëtimeve të drejtpërdrejta në llogarinë bankare të komunës, pastaj hartimi i raporteve dhe barazimi çdo ditë dhe për periudha të caktuara kohore të pagesave në arkë dhe depozitimeve të mjeteve në bankë.
- Përpunimi në free-balance dhe barazimi çdo ditë dhe muhori i të hyrave vetanake të depozituara në konton bankare të buxhetit të Komunës me programet dhe nënprogramet buxhetore të komunës dhe departamentet e MEF-it;
- Llogaritja dhe realizimi i të gjitha pagesave nga granti qeveritar, të destinuara për pagesën e pagave, mëditjeve dhe kompensimeve të tjera shtesë të personelit të SHCK-së, të këshilltarëve komunal, komiteteve dhe komisioneve.
- Tërheqja e avanseve të parave të gatshme i ashtuquajtur "pety cash" për programet e përcaktuara buxhetore në janar 2010 dhe rimbushjet e tyre në kontinuitet gjatë tërë vitit, kryerja e të gjitha pagesave në të gatshme sipas kërkesave dhe vendimeve të miratuara nga programet buxhetore në shumën e limituar të pagesave të faturave deri nën **100,00 euro** pastaj edhe aktivitetet e tjera si barazimi i shpenzimeve nga pagesat e kryera në format standarde dhe plotësimi i formave tjera sipas MEF-it departamentit të thesarit.

### ***SEKTORI – ZYRA E TATIMIT NË PRONË***

Barazimi dhe përmbyllja e plotë definitive e të gjitha depozitimeve dhe arkëtimeve të realizuara në vitin paraprak 2010 si të pagesave të realizuara nga arka e administratës Komonale, ashtu edhe përmes depozitimeve të realizuara në bankat komerciale.

#### **Janar - Shkurt**

- Finalizimi i punëve administrative dhe të gjitha pregaditjet tjera të nevojshme teknike rreth aktivitetit vijues të faturimit të obligimeve nga tatimi në pronë për vitin fiskal 2010 dhe përcjellja e të dhënave bazike "Data- Base" në departamentin e tatimit në pronë-MEF, për procedura të mëtejme lidhur me printimin dhe shpërndarjen nga ana e MEF dhe PTK, të faturave për vitin 2011.
- Kryerja e të gjitha punëve organizative, informative, teknike dhe zbatimi i formave më efikase për përfshirjen sa më të mirë të zonave tatimore dhe për fillimin e punës në vitin 2011, me programin e ri në rrjetin "on-line" të propozuar dhe të furnizuar nga MEF-i.
- Regjistrimi dhe mbajtja e saktë e pagesave të realizuara dhe evidentimi i borgjeve nga tatimobliguesit për periudhën e deritanishme të viteve fiskale 2002-2010 si dhe për vitin 2011 (kalkulimi i kamatave dhe ndëshkimeve), krahas operimit me të dhënat në softwer, mbajtja e evidencave të posaçme në Excel.

#### **Mars**

- Shqyrtimi i rregullores së tatimit në pronë.

#### **Maj**

- Përgatitja e të gjitha procedurave për shqyrtimin në afat ligjor të të gjitha ankesave të parashtruara nga qytetarët, dhe të adresuara komisionit të ankesave i formuar sipas vendimit të kryetarit.

### **Korrik-Gusht**

- Përpilimi dhe hartimi i raporteve ditore, javore mujore dhe vjetore lidhur me grumbullimet e realizuara të tatimit në pronë, nga i cili tatim me buxhetin e komunës për vitin 2011 parashikohet që këto të hyra komunale të jenë gjeneratori kryesor në krijimin e të hyrave vetanake në nivel të komunës .

### **Tetor - Nëntor**

- Lëshuarja obligative ligjore e vërejtjeve të fundit të cilët nuk kanë paguar obligimet e kështit I-rë dhe borgjeve të viteve paraprake nga faturat e pranuar të vitit 2011 .

### **Janar –Dhjetor**

- Ruajtja, rifreskimi dhe azhurimi permanent i të dhënave bazë, me përfshirjen e rianketimit dhe verifikimet e obligueshme të pronave të regjistruara, zgjerimi i bazës së të dhënave nga ndërtimet e reja të objekteve të banuara -funksionale dhe të pa aktivizuara (strukturat e ndërtimit të vrazhdë), pastaj modifikimet nga terreni dhe korrigjimet e të dhënave sipas kërkesave dhe ankesave të qytetarëve etj.
- Zbatimi konsekuent i të gjitha rregulloreve dhe udhëzimeve administrative nga lëmia e tatimit në pronë dhe bashkëpunimi i mëtejshëm me të gjitha Drejtoritë e Administratës Komunale dhe MEF-Departamenti i Tatimit në Pronë.

### ***SEKTORI I BUJQËSISË***

- Prej fillimit të vitit do të fillon konsolidimi i këtij sektori dhe grumbullimi i të dhënave dhe kryerja e detyrave dhe obligimeve sipas statutit.
- Ky program i punës do të ndihmon dukshëm në përmbushjen e drejtpërdrejt të punëve dhe detyrave të punës karshi kërkesave e shërbimeve të qytetarëve, përmes sigurimit të një funksionaliteti më efektiv dhe më transparent .
- Gjithsesi vlen të përmendet se në përbërjen e këtij programi operativ të punës do të renditen edhe aktivitetet e tjera , të cilat kanë të bëjnë me nevojat dhe kërkesat që mund të parashtrihen sipas aktualiteteve gjatë vitit 2011 që i përkasin fushëveprimtarisë së bujqësisë lidhur me :
  - subvencionimin e fermerëve(lopë, gjedha, dhi etj) dhe
  - subvencionimin e mbjelljeve vjeshtore nga ana e Ministrisë së Bujqësisë , Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Organizatave joqeveritare.

### ***SEKTORI I PYLLTARISË***

Ky sektor ka filluar prej korrikut të vitit 2010 dhe do të punon në mënyre kontinuele për kryerjen e detyrave të punës, mbrojtjen e pyjeve të komunës nga prerësit ilegal dhe bashkëpunimin me policinë dhe stafin në mënyrë sa më efikase.

### **Janar – Prill**

- Përgatitjet për pranimin e kërkesave për pyje private nga qytetarët e komunës së Hanit të Elezit.

- Planifikojmë 10 hektarë sipërfaqe për pyllëzim me fidane nëpër territorin e Hanit të Elezit në bashkëpunim me Ministrinë Bujqësisë , Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Organizatat joqeveritare.

#### **Maj – Tetor**

- Planifikojmë prerje para komerciale në vendin e quajtur “Ara e Cenës” dhe “Ornica “ në afërsi të fshatit Paldenicë dhe Neqavc.

#### **Janar - Dhjetor**

- Përpilimi dhe hartimi i raporteve javore, mujore, vjetore të fletëparaqitjeve , damkosjes së pyllit , fletë lëshimeve.etj.
- Raportet e fletëparaqitjeve kundërvajtëse dhe penale në gjykata të personave që i dëmtojnë pyjet .